



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2021:108869

Datë: 03.06.2021

Numri i dokumentit: 01846161

**C.nr. 349/17**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEGA NE DEÇAN Departamenti i Përgjithshëm,** civilo-juridik më gjyqtar Bekim Avdimetaj sekretaren juridike Sabiha Hoxha në çështjen juridiko kontestimore të paditsit K. (R.) H. nga fshati .....Komuna e ....., te cilin më autorizim e ka përfaqesuar avokati I. O. nga Deçani, kundër të paditurit A. M. nga fshati .....Komuna e ..... te cilin më autorizim e ka përfaqesuar avokati Q. F. nga Deçani ,për vërtetim pronësie, vlera e kontestit 5000.00 euro, pas mbatjes seancës te shqyrtimit kryesor me daten 12.06.2017,në prezencën e te autorizuarve te ndergjyqesve dhe palve te perpiluar me daten 20.06.2017 gjykata mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditsit K. (R.) H. nga fshati .....Komuna e ....., te cilin më autorizim e ka përfaqesuar avokati I. O..

**II. VËRTETOHET** se paditësi K. (R.) H. nga fshati .....Komuna e ..... , është pronar i patundshmerive te njesive kadastrale me numer P-70505002-00517-0 në vendin e quajtur Nermuline-Kojqine më sipërfaqe prej 873 m2 dhe te njesis kadastrale P-70505002-00518-0 ne vendin e quajtur Nermuline-Kojqine më sipërfaqe prej 6862 m2 duke filluar nga pika 1 deri në piken 7 mbi bazen e ekspertizes te kryer nga eksperti i gjedozis më daten 01.10.2015 ne fshatin .....ZK Deçan me çka **DETYROHET** i padituri, A. M. nga fshati .....Komuna e ....., qe t'ja njoh te drejtën pronësisë paditësit K. H. nga fshati .....Komuna e ..... duke lejuar marrjen e drunjeve dhe pastrimin e patundshmerive përgjatë megjes dhe ashtu qe në menyre te qete dhe te lire ta lejoj që ta shfrytëzoj, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes se këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit.

**III. DETYROHET** e paditura qe padisit në emer të shpenzimeve te procedures kontestimore te ja paguan shumen prej 741.00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim, të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit.

**A r s y e t i m**

Paditësi K. (R.) H. nga fshati .....Komuna e ....., te cilin më autorizim e ka përfaqesuar avokati I. O. nga .....ka parqitur padi ne kete gjykate me daten 20.11.2017 kundër të paditurit A. M. nga fshati .....Komuna e ..... te cilin më autorizim e ka përfaqesuar avokati Q. F. nga Deçani ,për vërtetim pronësie se është pronar i njesive njesive kadastrale me numer P-70505002-

00517-0 ne vendin e quajtur Nermuline-Kojqine më sipërfaqe prej 873 m<sup>2</sup> dhe i njesis kadastrale P-70505002-00518-0 ne vendin e quajtur Nermuline-Kojqine me sipërfaqe prej 6862 m<sup>2</sup> ne fshatin .....ZK Deçan.

### **Juridiksioni dhe kompetenca e gjykatës**

Neni 37 par.1 i Ligjit të Procedurës Kontestimore parashihet, nëse me ligj nuk është caktuar kompetenca ekskluzive territoriale e ndonjë gjykate tjetër, për procedimin e çështjes është kompetente gjykata e kompetencës së përgjithshme për palën e paditur.

### **Pretendimet e të autorizuarve të ndërgjyqësve**

**I autorizuari i paditësit av. I. O.** gjate seances pergaditore dhe shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet pran kekespadi të dorzuar në gjykate se eksperti i gjedozis F. H. i caktuar nga gjykata ne ekspertizën e tij të datës 01.10.2015 më rastin e daljes ne vende ngjarje më gjykatën për vendosjen e kufirit kadastral në ekspertizën e tij e ka përshkruar se ekziston një dallim i madh ne mes matjeve te para te vitit 1932, çka do te jen bazë për vendosjen e kësaj qeshtje, ne raport me gjendjen sipas aero fotografimit qe ka hyre ne fuqi ne vitin 1990 .

Ne këtë ekspertizë thuhet se gjendja në teren përputhet me gjendjen si ne dokumentin pronësor certifikatën, ndërsa ne raportin shtesë ku kemi kërkuar sqarime me datën 04.04.2017 i njëjti prape e ka cekur se kjo gjendje nuk përputhet sipas matjeve te cekura me larte ne padi. Kemi kërkuar qe si përfaqja e njesis kadastrale me numer P-70505002-00518-0 në vendin e quajtur Nermuline-Kojqine me sipërfaqe prej 6862 m<sup>2</sup> ne fshatin .....ZK Deçan te na dorëzohet aq sa shkruhet ne dokumentin pronësor 6862 m<sup>2</sup>, çka do te thotë se eksperti thotë se egziston dallim i madh ne mes te këtyre dy periudhave ndersa ne anën tjetër deklaroi se sipërfaqja eshte e pandryshuar .

Në përmes kësaj padie ceku serish se sipas matjeve te ekspertit dallimi i madh shifet se ekziston nga pika 1 deri ne piken 7 ku gjendja kadastrale nuk perputhet me gjendjen e vitit 1932, po as me gjendjen faktike ne teren.

**I autorizuari i paditësit i lartshënuar edhe ne fjalën e tij përfundimtare** ka deklaruar se nga administrimi i provave në këtë qeshtje juridiko kontesti more vërtetohet baza e kerkes padis si dhe precizimit i bërë me datën 14.05.2018, nga se nga dokumentet pronesore poseduese ,plani katastral dhe dokumentet tjera kadastrale vertetojn se paditësi K. H. është pronar i ngastrës kadastrale 00518-0 me sipërfaqe te përgjithshme 6862m<sup>2</sup> gjegjësisht i sipërfaqes kontestuese prej 78m<sup>2</sup>. Ku me rastin e daljes se ekspertit ne teren tani veç gjendja kadastrale nuk përputhet me gjendjen faktike ne teren per shkak te gabimeve teknike qe kanë rrjedhur gjate deshifrimit te ngastrave pas aero fotografimit te vitit 1983 e qe ka hyr ne fuqi ne vitin 1990.

I autorizuari i paditësit i lartshënuar gjithashtu ka deklaruar se me rastin e daljes ne teren eksperti gjeodet ka ber krahasimin e gjendjen kadastrale te vitit 1983gjendjes se aero- fotografimit më gjendjen faktike ne teren dhe tani kufiri kontestues duke filluar nga pjesa perëndimorë pika 1 deri ne piken 7 ne anën lindore ku ndryshimi ne mes te këtyre kufirav qe u krijuan eshte 78m<sup>2</sup>te cilën sipërfaqe deri ne momentin e paraqitjes se padis e ka pasur ne mbajtje dhe ne posedim paditësi K. H. . Nga te gjitha këto konsideroj se jan te mjaftueshme qe bazën dhe kërkesë padinë

e mbajnë te bazuar dhe gjykates i propozoj qe te bie aktgjykim vërtetues. Po ashtu i kerkojm edhe shpenzimet e krijuar te procedures kontestimore te llogaritur sipas tarifës se Odes se Avokateve te Kosovës qe gjykata ta detyroj te paditurin për ketë shuma si vijon :për përpilimin e padis 101.00 euro,per taksen gjyqësore 50.00 euro ,seancën gjyqësorë ne shumë prej 270 X 5 ne shumen prej 1330.00 euro për ekspertin e gjedozis 100.00 euro qe është deklaruar ne kete gjykat te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nen kërcenim te përmbarrimit me dhune.

**I autorizuari i te paditurit av. Q. F.** gjate seances pergaditore dhe te shqyrtimit kryesore ka deklaruar se nuk e kemi kontestuar ekspertizën si ate te eksperti Xh. T.,si atë te caktuar nga ana e gjykates F. H. dhe jemi dakorduar qe te caktohet kufiri sipas gjendjes te cilën e kanë konstatuar ekspertet kur bashke me ndërgjyqësoret me 28.08.2017 kemi shkuar ne vend nuk e kemi vërejtur asnjë shufër metalike te cilat ishin te vendosura në shtat pika te caktuara nga eksperti se nga kush jan hequr këto pika nuk me është ditur, mund te jen te hequr nga paditësi ose nga dikush i afërm i tij .

I autorizuari i paditurit i lartshënuar gjate seancës te shqyrtimit kryesore ka deklaruar se paditësi përmes të autorizuarit të tij me 24.08.2017 e ka dërguar propozim për ekzekutim përmbarruesit privat Xh. R. në Gjakovë për përmbarrimin e vendimit gjyqësor të kësaj gjykate , nder të tjera është cekur se debitori tani i padituri A. M. nuk e njeh aktgjykimin e formës se prerë dhe të ekzekutueshëm të kësaj gjykate C.nr. 88/16 prej 28.04.2017. Ç ‘është e vërteta për aktgjykimin e sipër permendur nuk e kemi ushtruar ankesë. Ç’ është e vërteta në procesverbali e përmbarruesit privat të dt. 14.11.2017 i përpiluar në parcelën katastrale 00518-0 ndër të tjerat është cekur se kreditori nuk pranon vendosjen e prikave kufizuese në mes të ngastrave katastarle të cilat janë objekt i këtij shqyrtimi kryesor pa u bërë matja e tërësishme e livadhit sipërfaqja e ti cilit duhet të jetë 6862 m2. Ç ‘është e vërteta këtë çështje e kemi iniciuar bashkë me të paditurin që lirisht ta bëje matjen e kësaj parcele ngastre dhe po që se sipërfaqja e livadhit është më e vegël se sa të dhënat katastrale le të hyjë në pronën private deri sa të arrihet e njëjta sipërfaqe.

**I autorizuari i te paditurit i lartshenuar ne fjalën e tij përfundimtare** ka deklaruar se pa mëdyshje u vërtetua se padia e palës paditëse është pa bazë juridike ketë e argumentoj më te dhënat si vijojnë i autorizuari i paditësit ne fjalën përfundimtare ne mes tjerash u deklarua se .Nga momenti i paraqitjes se padis ne gjykatë paditësit i mungojnë 78m2 nga sipërfaqja e tërësishme e parcelës se tij numër 00518-0”,atëherë me qfar veprimi i padituri i paska përvetësuar këto 78m2.

Ne terminologjinë juridike ekziston parimi mi jap faktet ta dajë drejtësinë .Me qfar fakti paditësi e bazon padinë e tij se i mungojn 78m2 pasi qe me asnjë prove deri me tani nuk e ka vërtetuar pretendimin e tij .

Për çudi paditësi ekspertizën e ekspertit gjyqësor nuk e ka kundërshtuar më pare por edhe tani te njëjtën nuk e kundërshton. Nuk e kundërshtojnë as i paditur .Vija kufizuese sipas ekspertizës të ekspertit F. H. është përcaktuar më 7 pika me një gjatësi rreth 165m, mirëpo kur ne ishim ne vend me 11.08.2017 edhe pse pikat ishin përcaktuar me shufra metalike për qudi asnjëra nuk ishin ne vendin e duhur .

Nga aero incizimi e deri me implementimin e matjeve sipas tij kadastri ka pritur për plot 7 vjet dhe asnjëra nga palët ndërgjyqës nuk e kan kontestuar kufirin i cili tani po kontestohet ne çështjet juridiko kontestimore ekziston parimi i ekonomizimit te procedurës andaj per cka pala paditëse

kete qeshtje nuk e ka vene ne veprim me rastin e vendosjes se kësaj qeshtje sipas padis se pare dhe krejt për fund i propozojmë gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si te pa bazuar se gjate këtyre seancave te shqyrtimeve kryesore me asnjë provë dhe me asnjë fakt, nuk e ka justifikuar bazushmerin e padis sa i përket shpenzimeve procedurale gjykatës do te ia ofroj ne afat prej 3 ditëve listën e specifikuar te shpenzimeve .

### **Pretendimet e palëve ndërgjyqësve**

**Paditësi K. H.** në cilësinë e palës gjate seances shqyrtimit kryesor ka deklaruar mexha ka qenë e rregulluar edhe para daljes se ario ingjizimit dhe prej sa e mbajë mend unë janë ashtu bagrenat dhe shelnjët kanë qenë brenda telit.

**I padituri A. M.** në cilësinë e palës gjate seances shqyrtimit kryesor ka deklaruar se nuk i kundërshton matjen gjeodezike që janë bërë nga ekspertët. Që fillimit është bërë nga eksperti Gjelil Terteni e pastaj edhe nga eksperti F. H. bashkë me gjykatën dhe nuk kërkoj asgjë ma shumë nga paditësi vetëm atë që është e imja.

### **Faktet e vertetura**

-Nga Historiati me numër te lendes Nr 88/16 te dates 09.12.2016 i leshuar nga Drejtoria per gjedozi dhe kadaster K-Deçan se ngastra më numer 518 me kultur livadhe e klasit 2 e cila është ne emër te K. (R.) H. me siperfaqe prej 0.68.62 fshati .....kjo gjendje egziston qe nga matja e fundit e cila është bere ne vitin 1983 (ajroinqizimit) dhe ka hyre ne fuqi ne vitin 1990. Ndersa sipas shenimeve te vitit 1932 (matjet e para) kjo prone ka qen pjese e parcelave me nr. 506,385 dhe 384 ZK fshati .....K-Deçan.

-Eksperti gjedozis F. H. më rastin e daljes në vende te ngjarjes me gjykatën dhe palet ndërgjyqese ne ekspertizen e tij dorzuar gjykatës me shkrim ne baze te dhenave kadsatrale paditësi K. (R.) H. nga fshati .....Komuna e ....., është pronar i patundshmerive te njesive kadastrale me numer P-70505002-00517-0 ne vendin e quajtur Nermuline-Kojqine me siperfaqe prej 873 m2 dhe te njesis kadastrale P-70505002-00518-0 ne vendin e quajtur Nermuline-Kojqine me sipërfaqe prej 6862 m2. Përcaktimi i kufirit në mes ngastrave me shenime zyrtare nga aerofotografimi .Gjithsejt jan vendosura 7 shenja më hekura duke filluar nga pika 1 deri ne piken 7, qe është bere percaktimi i kufirit te ngastres me nr 516-0,rruge private dhe ngastres me nr 518-0 qe është bere edhe paraqitja e gjendjes më te para aerofotografimit te rruges e vitit 1932 konkretisht ngastra me nr.511,qe perputhet shum mire me gjendjen faktike ne teren .Pra dallim i madhe i shfaqur ne gjendjen aerofotografimit qe nuk shfaqet edhe ne gjendjen e vitit 1932.Pra ka pasur mundesi qe kufiri te jete sinjalizuar në mënyre jo te rregullt gjate kohes aerofotografimit, ose te kete rrjedhur gabimi gjate kohes se deshifrimit ne procesin aerofotografimit . Te cilës ekspertize të gjeodezisë të ekspertit F. H. gjykata në tersi ja fali besimin pasi qe e njëjta , ishte punuar në mënyre profesionale edhe ishte ne përputhje te plote

edhe me gjendjen faktike, te konstatuar nga eksperti i gjeodezisë i lartshënuar me rastin e daljes ne vend shikim.

-Eksperti i gjeodezisë B. E. nga Drejtoria per gjedozi dhe kadaster në Deçan i propozuar nga i autorizuari paditesit gjate seances te shqyrtimit kryesore ka deklaruar se në bazë të dhënave që i posedon Drejtoria për Gjeodezi dhe kadaster në K-Deçan faktikisht gjendja e 83-tës të ario fotografimit me gjendjen e me parshme ka ndryshime për ngastrën 516 edhe ngastra 518 , këto i ka sqaruar edhe eksperti i gjedozis F. H. në ekspertizen e tij me shkrim. Qe ekzistojnë gabime teknike gjatë sinjalizimit të shenjave të viti 1983 si dhe gjatë deshifrimit dhe valide ne Drejtorin per gjedozi dhe kadaster ne K-Deçan janë të vitit 1983 e cila ka hyrë në fuqi në vitin 1990, te cilave provave të lartshënuar gjykata ja ka falur besimin.

Pasi që gjykata qe bëri vlerësimin e provave veç e veç dhe atyre bashkërisht duke u mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Administrimi i provave gjate shqyrtimit kryesore**

Gjykata gjate shqyrtimit kryesore ka bere administrimin e provave në këtë çështje kontestimore që Lexohet padia dorëzuar ne gjykatë me datën 20.12.2017,lexohet certifikata e pronesis me numër 12-94701-1300 e lëshuar nga zyra katastrale Komuna e Deçanit me datën 19.01.2017 ne emër te K. H. ,lexohet kopja e planit ne emër te K. R. H. nga fshati .....me numër te flet posedimit 23 eleshuar nga zyra katastrale komuna e Decanit me datën 14.10.2005,lexohet eksperita gjyqesore e kryer nga eksperti F. H. me rastin e daljes ne vend te ngjarjes me datën 11.08.2015,lexohet historiati i lëshuar nga zyra katastrale Komuna e Decanit me numër 88/16 te datës 09.12.2016,lexohet parashtrësja e te autorizuarit te paditësit dorëzuar gjykatës ne lidhje me precizimin e kërkesë padis me datën 14.05.2018,te cilave provave qe gjenden ne shkresat e lendes gjykata ja ka falur besimin.

### **Vlerësimi juridik i çështjes**

Nga provat e nxjerra si më larte duke çmuar me kujdes çdo provë veç e veç dhe te gjitha se bashku dhe nga kjo gjendje e vërtetuar faktike si më larte, gjykata erdhi ne përfundim dhe vërtetoi ne mënyrë te pa dyshimte kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe në kuptim te nenit 10,18 28,36,37, te Ligjit Nr.03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, të Republikës së Kosovës dhe gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që e padituri paditësit të ia shpërblej shpenzimet e procedurës, gjykata e mbështeti dispozitat e nenit 449 par 1,2 452 par. 1, 463 par 1, 2 të LPK-së sepse paditësi si gjyq fituese, i takon e drejta në shpërblimin e shpenzimeve të procedurës më kusht që i autorizuari i paditësit ti ketë specifikuar provuar sipas tarifës se Odes se Avokatëve të Kosovës dhe atë: për përpilimin e padis shumën prej 101.00 euro, për katër seanca 4x135.00

në shumën prej 540.00 euro, për deklarimin e ekspertit të gjeodezisë nga Drejtoria për gjeodezi dhe kadastrë K-Deçan në seancën e shqyrtimit kryesor shumën prej 100.00 euro, të gjitha këto në shumën total prej 741.00 euro. Mbi këtë shumë të gjykuar gjykata i refuzon si të pa bazuar .

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA NE DEÇAN , më datë 31.08.2017 .**

**Sekretarja juridike  
Sabiha Hoxha**

**G j y q t a r i  
Bekim Avdimetaj**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e përmes kësaj gjykate.

.